FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 76

Tiranë – E premte, 20 maj 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 39/2022, datë 21.4.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 12.3.2022, "Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar".....	9977
Ligj nr. 40/2022, datë 21.4.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 18.3.2022, "Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara (amendimi i tretë) në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave", të ndryshuar.....	9977
Ligj nr. 41/2022, datë 21.4.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 18.3.2022, "Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg".....	9977
Ligj nr. 42/2022, datë 21.4.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar".....	9978
Ligj nr. 43/2022, datë 21.4.2022	Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.....	9978
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 18.5.2022	Për caktimin e ditës së mërkurë, datë 25.5.2022, ditë pushimi	9984
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 318, datë 18.5.2022	Për kalimin te bashkitë Durrës, Kavajë dhe Krujë të objekteve arsimore.....	9984

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 18.5.2022	Për kalimin te bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë të njësive individuale të banimit.....	9986
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 18.5.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 45, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Shijak, Bashkia Shijak, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese".....	9990
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 321, datë 18.5.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 279, datë 12.5.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit social-kulturor, Pallati i Kulturës, Bashkia Shijak, dhe caktimin e Bashkisë Shijak si njësi zbatuese".....	10000
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 18.5.2022	Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Belsh, të pronës nr. 306, me emërtim "Ish-reparti ushtarak nr. 7040 (BK dhe grup artilerie)", me vendndodhje në Trojas, Belsh, Elbasan, zona kadastrale 3647, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, dhe në vendimin nr. 886, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Belsh, të qarkut të Elbasanit", të ndryshuar.....	10000
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 324, datë 18.5.2022	Për përcaktimin e kërkesave dhe kushteve që duhet të plotësojë një standard matjeje për t'u deklaruar etalon kombëtar matjeje	10002
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 18.5.2022	Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.....	10003
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 18.5.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 457, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurave për pjesëmarrje në qendrën e trajnimeve në fushën e pronësisë industriale, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse".....	10005
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 18.5.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1088, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente dhe nga subjektet e detyruara", të ndryshuar.....	10006
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 18.5.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore", të ndryshuar.....	10010
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 18.5.2022	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.....	10010

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 331, datë 18.5.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 24, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore", të ndryshuar.....	10011
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 18.5.2022	Për përcaktimin e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese.....	10013
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 333, datë 18.5.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 113, datë 17.2.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri".....	10013
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 11, datë 16.5.2022	Për certifikimin e hartuesve të testeve dhe vlerësuesve të provimeve kombëtare.....	10014
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 135/4, datë 17.5.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor *By Pass* Fier"', të ndryshuar.....	10015

LIGJ
Nr. 39/2022

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 5, DATË 12.3.2022, "PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8450, DATË 24.2.1999, 'PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 12.3.2022, "Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar".

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 21.4.2022.

LIGJ
Nr. 40/2022

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 6, DATË 18.3.2022, "PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE TË NËNSHKRUARA (AMENDIMI I TRETË) NË MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 18.3.2022, "Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara (amendimi i tretë) në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave", të ndryshuar.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 21.4.2022.

LIGJ
Nr. 41/2022

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 7, DATË 18.3.2022, "PËR TRANSPARENCËN DHE MONITORIMIN E ÇMIMIT PËR DISA PRODUKTE USHQIMORE BAZË DHE PRODUKTE TË TJERA TË LIDHURA ME TO SI PASOJË E SITUATËS SË VEÇANTË TË KRIJUAR NË TREG"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 18.3.2022, "Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg".

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 21.4.2022.

LIGJ
Nr. 42/2022

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 8, DATË 25.3.2022, "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8450, DATË 24.2.1999, 'PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE', TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre', të ndryshuar".

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 21.4.2022.

LIGJ
Nr. 43/2022

PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME[1]

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave, masave dhe politikave shtetërore për klasifikimin, nxitjen e krijimit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i një kuadri rregullator ligjor dhe institucional për përkufizimin dhe kategorizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe për përcaktimin e politikave shtetërore që zbatohen në mbështetje të tyre.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Biznese të palistuara" janë sipërmarrjet individuale që ofrojnë kapital në shuma të vogla për bizneset, në këmbim të një pjese të aksioneve të tyre, për rastet kur bankat ose institucionet financiare nuk kanë interes të ndërveprojnë.

2. "Fonde të zhvillimit" janë ato fonde që sigurojnë mbështetje financiare për zhvillimin e zonave në fusha të caktuara, të tilla si: investimet në kapacitetet e prodhimit, ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës, si dhe investimet në fushën e kujdesit shëndetësor e të edukimit.

3. "Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve NMVM" është fondi i krijuar nga buxheti i shtetit me qëllim zhvillimin e ndërmarrjeve NMVM.

4. "Investimi i kapitalit të përbashkët" është përdorimi i kapitalit të përbashkët në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, në çastin e krijimit të tyre ose në fazën fillestare të zhvillimit të tyre.

[1] Ky projektligj është përafruar pjesërisht me rekomandimin e Komisionit të BE-së të 6 majit 2003 në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (Njoftimi zyrtar L 124, 20/05/2003 P. 0036 – 0041). CELEX 32003H0361.

5. "Ndërmarrje" është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar, i cili ushtron veprimtari ekonomike.

6. NMVM-të janë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, që janë regjistruar në regjistrin tregtar, në të cilat me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 7 të këtij neni, organet publike direkt ose indirekt nuk mund të zotërojnë më shumë se 25% të kapitalit apo të të drejtave të votës. "Ndërmarrje të reja" janë ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme, të cilat janë regjistruar në regjistrin tregtar prej jo më shumë se 12 muajsh.

7. "Ndërmarrje autonome" është çdo ndërmarrje, e cila e vetme ose bashkërisht me një ose më shumë ndërmarrje të lidhura, nuk zotëron më shumë se 25% të kapitalit ose të të drejtave të votës së një ndërmarrjeje tjetër, si dhe nuk është e lidhur me një ndërmarrje tjetër në asnjë nga format e parashikuara në pikën 8 të këtij neni. Një ndërmarrje mund të jetë autonome edhe nëse pragu prej 25% plotësohet ose tejkalohet nga investitorët si vijon, me kusht që këta investitorë të mos jenë të lidhur në kuptim të pikës 8 të këtij neni individualisht ose bashkërisht me ndërmarrjen në fjalë:

a) korporatat publike të investimeve, shoqëritë e kapitalit sipërmarrës, individët ose grupet e individëve me aktivitet të rregullt në investimet e kapitalit sipërmarrës, të cilët investojnë kapitalin e vet në ndërmarrje të palistuara, me kusht që investimi total i bizneseve të palistuara në të njëjtën ndërmarrje të jetë më pak se 30 000 000 lekë;

b) institucionet e arsimit të lartë ose qendrat jofitimprurëse kërkimore;

c) investitorët institucionalë, përfshirë fondet rajonale të zhvillimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për zhvillimin rajonal dhe kohezionin;

ç) njësitë e vetëqeverisjes vendore me një buxhet vjetor me më pak se 10 milionë lekë dhe më pak se 5 000 banorë.

Në kuptim të kësaj pike, nuk ekziston asnjë ndikim dominues nëse investitorët e përcaktuar në shkronjat "a" deri "ç", pavarësisht nga të drejtat e tyre si aksionarë, nuk përfshihen direkt ose indirekt në menaxhimin e ndërmarrjes në fjalë.

8. "Ndërmarrje të lidhura" janë ndërmarrjet që kanë një nga lidhjet e mëposhtme:

a) një ndërmarrje ka shumicën e të drejtave të votave të aksionarëve ose anëtarëve në një ndërmarrje tjetër;

b) një ndërmarrje ka të drejtë të emërojë ose të largojë shumicën e anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese ose mbikëqyrëse të një ndërmarrjeje tjetër;

c) një ndërmarrje ka të drejtë të ushtrojë një ndikim dominues mbi një ndërmarrje tjetër në bazë të një kontrate të lidhur me atë ndërmarrje ose të një përcaktimi në memorandum apo nenet e statutit;

ç) një ndërmarrje, e cila është aksionare ose anëtare e një ndërmarrjeje tjetër, kontrollon e vetme, në përputhje me një marrëveshje me aksionarët e tjerë ose anëtarët e asaj ndërmarrjeje, shumicën e të drejtave të votave të aksionarëve ose anëtarëve në atë ndërmarrje.

9. "Ndërmarrje partnere" janë të gjitha ndërmarrjet që nuk klasifikohen si ndërmarrje të lidhura në kuptim të pikës 8 të këtij neni, ndërmjet të cilave një ndërmarrje zotëron vetëm ose së bashku me një ose më shumë ndërmarrje të lidhura 25% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës së një ndërmarrjeje tjetër. Ndërmarrjet e lidhura me një ose më shumë ndërmarrje të tjera ose ndonjë prej investitorëve të përmendur në këtë pikë konsiderohen se janë të lidhura.

10. "Shifër afarizmi" janë shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë një viti, të cilat i korrespondojnë shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve, ofruar të tretëve.

11. "Shoqëri sipërmarrëse e kapitalit" janë shoqëritë aksionare dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, që kanë për objekt investimin e kapitalit në ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme.

12. "Treg i lidhur" është tregu i produkteve apo shërbimeve në diversifikim, të vendosura direkt sipër ose poshtë tregut përkatës.

Neni 4
Kategoritë e NMVM-ve

1. NMVM-të janë tërësia e ndërmarrjeve në të cilat punësohen më pak se 250 persona dhe realizojnë një shifër afarizmi ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.

2. Ndërmarrje e vogël konsiderohet një ndërmarrje me më pak se 50 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.

3. Mikrondërmarrje konsiderohet një ndërmarrje me më pak se 10 persona të punësuar, e

cila ka një shifër afarizmi ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.

4. Ndërmarrje e mesme konsiderohet një ndërmarrje me 50 persona të punësuar deri në 249 persona të punësuar, e cila ka një shifër afarizmi ose një bilanc total vjetor nga 50 milionë lekë deri në 250 milionë lekë.

5. Nëse një ndërmarrje nuk përmbush njëkohësisht kriteret e vendosura për kategoritë përkatëse të NMVM-ve, sipas pikave 1 deri 4 të këtij neni, kategorizimi bëhet mbi bazën e numrit të personelit.

6. Për qëllime statistikore, ndërmarrjet klasifikohen në:

a) mikrondërmarrje: 0 deri 9 persona;

b) ndërmarrje të vogla: 10 deri 49 persona;

c) ndërmarrje të mesme: 50 deri 249 persona.

Neni 5

Deklarata për kategorinë e NMVM-ve

1. Ndërmarrjet plotësojnë deklaratën e kategorisë si ndërmarrje autonome, ndërmarrje partnere ose ndërmarrje e lidhur, në të cilën përfshihen edhe të dhënat e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji. Deklarata plotësohet edhe në rastet kur shpërndarja e kapitalit është e tillë që e bën të pamundur identifikimin e zotëruesve. Ndërmarrjet kanë detyrimin për plotësimin/dorëzimin e deklaratës, pavarësisht kontrolleve dhe hetimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimet.

2. Mënyra dhe forma e deklarimit të kategorisë së ndërmarrjes përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për ekonominë.

Neni 6

Burimet e të dhënave për llogaritjen e personelit, vlerës së qarkullimit dhe periudhës së raportimit për NMVM-të

1. Të dhënat për numrin e të punësuarve dhe vlerën e qarkullimit merren nga pasqyrat financiare vjetore të depozituara për publikim pranë autoritetit përkatës ku janë regjistruar, në përputhje më legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Vlera e qarkullimit llogaritet duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe taksat e tjera indirekte.

2. Në rastet kur nga pasqyrat financiare vjetore të depozituara për publikim vlerësohet se në baza vjetore është ulur ose tejkaluar numri i të punësuarve, ndërmarrja nuk e humbet ose fiton statusin e ndërmarrjes mikro, ndërmarrjes së vogël apo ndërmarrjes së mesme, me përjashtim të rastit kur këto tavane tejkalohen për dy periudha vjetore llogaritjeje të njëpasnjëshme.

3. Në rastin e ndërmarrjeve të reja, pasqyrat financiare të të cilave nuk janë miratuar ende, të dhënat sigurohen nëpërmjet vetëdeklarimit gjatë vitit financiar.

Neni 7

Personeli për periudhën e raportimit të NMVM-ve

1. Numri i personelit korrespondon me numrin e njësive vjetore të punës. Numri i njësive vjetore të punës është ekuivalenti i numrit të të gjithë të punësuarve që kanë punuar me kohë të plotë në ndërmarrje ose për llogari të saj gjatë gjithë vitit, i cili llogaritet si numri i orëve gjithsej të punës së kryer në ndërmarrje në raport me numrin gjithsej të orëve të punës me kohë të plotë.

2. Puna e personave, të cilët nuk kanë punuar gjatë gjithë vitit, puna e atyre që kanë punuar me kohë të pjesshme, pavarësisht kohëzgjatjes, si dhe puna e të punësuarve sezonalë përfshihen në numrin e orëve gjithsej të punës së kryer në ndërmarrje.

3. Personeli përbëhet nga:

a) punëmarrësit;

b) punëdhënësit;

c) partnerët që angazhohen në mënyrë të vazhdueshme në aktivitetin e ndërmarrjes dhe që përfitojnë nga përparësitë financiare të saj;

ç) administratorët.

4. Punonjësit në kohë prove dhe studentët që angazhohen në trajnime profesionale me kontratë nuk përfshihen në personel.

Neni 8

Llogaritja e të dhënave për NMVM-të

1. Të dhënat në ndërmarrjet autonome, përfshirë edhe ato për numrin e të punësuarve, përcaktohen në bazë të pasqyrave financiare të ndërmarrjes.

2. Të dhënat e një ndërmarrjeje, që ka ndërmarrje partnere ose ndërmarrje të lidhura, përcaktohen në bazë të llogaritjeve edhe të të dhënave të ndërmarrjeve të tjera ose, aty ku ekzistojnë, në bazë të llogarive të konsoliduara të ndërmarrjes ose të pasqyrave financiare të konsoliduara, në të cilat ndërmarrja është përfshirë nëpërmjet procesit të bashkimit.

3. Të dhënave të referuara në pikën 1 të këtij neni u shtohen edhe të dhënat e çdo ndërmarrjeje partnere. Mbledhja bëhet sipas përqindjes në kapital ose të të drejtave të votës, cilado qoftë më e lartë. Në rast të pjesëmarrjes në disa ndërmarrje, zbatohet përqindja më e lartë.

4. Të dhënave të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni u shtohen 100% e të dhënave të çdo ndërmarrjeje, e cila është e lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me ndërmarrjen në fjalë, nëse këto të dhëna nuk janë përfshirë në pasqyrat financiare.

5. Në zbatim të pikës 2 të këtij neni, të dhënat e ndërmarrjes partnere të ndërmarrjes në fjalë përftohen nga pasqyrat financiare të tyre. Të dhënave u shtohet edhe 100% e të dhënave të ndërmarrjeve, të cilat janë të lidhura me ndërmarrjet partnere, përveç kur të dhënat e llogarive të tyre përfshihen nëpërmjet konsolidimit.

6. Në zbatim të pikës 2 të këtij neni, të dhënat e ndërmarrjeve që janë të lidhura me ndërmarrjen në fjalë përftohen nga pasqyrat financiare dhe të dhënat e tjera të konsoliduara të tyre, nëse ka. Këtyre të dhënave iu shtohen edhe të dhënat për çdo ndërmarrje të mundshme partnere të asaj ndërmarrjeje të lidhur, përveçse kur këto janë përfshirë në pasqyrat financiare të konsoliduara, me të paktën një përqindje proporcionale me përqindjen e përcaktuar sipas pikës 3 të këtij neni.

7. Kur në pasqyrat financiare të konsoliduara nuk pasqyrohen të dhënat për numrin e të punësuarve për një ndërmarrje të caktuar, numri i të punësuarve llogaritet duke shtuar të dhënat nga ndërmarrjet e saj partnere dhe nga ndërmarrjet me të cilat ndërmarrja në fjalë është e lidhur.

8. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr udhëzim në zbatim të këtij neni.

KREU II
MBËSHTETJA SHTETËRORE PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 9
Dhënia e mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme

1. Dhënia e mbështetjes shtetërore për NMVM-të, pavarësisht përcaktimeve të bëra në nenin 4 të këtij ligji, mund të bazohet edhe vetëm te plotësimi i kriterit të numrit të personelit, në përputhje me parashikimet në fuqi për ndihmën shtetërore.

2. Ndihma shtetërore dhe ndihma *de minimis* jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore dhe zbatohet pas autorizimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

3. Mbështetja për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme garanton në çdo rast akses gjinor të balancuar.

Neni 10
Format e mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme

Format e mbështetjes shtetërore që jepen për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përfshijnë kryesisht:

a) mbështetje financiare nga buxheti i shtetit;

b) mbështetje financiare nga partnerët për zhvillim vendës ose të huaj;

c) garanci shtetërore të huas në përputhje me legjislacionin në fuqi për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë, parimet dhe rregullat fiskale mbi qëndrueshmërinë e borxhit shtetëror, si dhe kufizimet e borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore të huas, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ligjet vjetore të buxhetit;

ç) shërbime publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve të dhëna në këtë ligj.

Neni 11
Mbështetja financiare buxhetore

1. Me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, sipas shkronjës "a" të nenit 10 të këtij ligji, krijohet fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve, i cili financohet nga buxheti i shtetit.

2. Fondi përdoret për dhënien e granteve për NMVM-të, me qëllim zbatimin e programeve që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë, artizanatit, zhvillimin e të mësuarit rreth ndërmarrjes, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja si rezultat i kërkim-zhvillimit, zhvillimin e aftësive të ndërmarrjes, inovacionin, rinovimin e teknologjisë, ndërkombëtarizimin e zhvillimin e NMVM-ve dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse.

3. Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve administrohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

4. Krijimi, funksionimi dhe shpërblimi i anëtarëve të bordit vlerësues të kërkesave, si dhe procedura konkurruese për dhënien e granteve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Kriteret e përgjithshme të përfitimit të mbështetjes financiare buxhetore për NMVM-të janë:

a) të jenë persona fizikë apo juridikë, të regjistruar në regjistrin tregtar, për jo më pak se 12 muaj;

b) të mos jenë në proces falimentimi;

c) të kenë paguar rregullisht sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore;

ç) të mos kenë detyrime ndaj organeve doganore dhe tatimore në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi;

d) të kenë dorëzuar deklaratën në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 5 të këtij ligji.

6. Përcaktimi i masës së përfitimit, kriteret dhe kushtet e veçanta të përfitimit për NMVM-të përcaktohen çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) administron një portal elektronik për instrumentet financiare të krijuara me fonde nga buxheti i shtetit dhe me partnerët për zhvillim. Çdo institucion, që ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ngarkohet që brenda 5 ditëve përpara fillimit të zbatimit të skemës të paraqesë informacion pranë AIDA-s.

Neni 12
Garancitë shtetërore të huas

Në rastet kur në zbatim të politikave të ndërmarra për mbështetjen e kreditimit të ndërmarrjeve vendoset dhënia e garancisë shtetërore, Këshilli i Ministrave përcakton me vendim fondin, sektorët, si dhe kushtet e kriteret për garantimin e huas për mbështetjen e ndërmarrjeve, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

Neni 13
Shërbimet publike për ndërmarrjet

1. AIDA ofron/siguron shërbimet publike të nevojshme për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Përveç parashikimeve të dhëna në legjislacionin në fuqi për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, AIDA kryen funksionet e dhënies së informacionit, këshillimit, zhvillimit të biznesit, trajnimit, zhvillimit profesional apo ritrajnimit, dhënies së shërbimeve metodologjike për ndërmarrjet, si edhe personat fizikë që synojnë të krijojnë një ndërmarrje.

2. Dhënia e shërbimeve publike për ndërmarrjet përballohet nga buxheti i shtetit brenda tavaneve buxhetore të alokuara për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për mbështetjen e ndërmarrjeve.

Neni 14
Raportet vjetore

1. Të gjitha institucionet shtetërore, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, japin informacion me shkrim pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për mënyrën dhe ecurinë e zbatimit të skemave mbështetëse financiare dhe mbështetjen publike për NMVM-të brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

2. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve brenda datës 30 qershor të çdo viti paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë

raportin vjetor të vitit pararendës për skemat mbështetëse për NMVM-të.

Neni 15
Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve

1. Me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, Këshilli i Ministrave miraton Strategjinë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve së bashku me planin e veprimit.

2. Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve përcakton vizionin, objektivat, përparësitë e promovimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve e investimeve, si dhe rolin e njësive të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore për zbatimin e saj.

Neni 16
Burimet e financimit të NMVM-ve

Aktivitetet në mbështetje të zhvillimit të NMVM-ve financohen nga buxheti i shtetit brenda tavaneve buxhetore të institucioneve të përfshira, në përputhje me masat konkrete të parashikuara në Strategjinë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve.

KREU III
KËSHILLI KONSULTATIV PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 17
Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet

1. Këshilli Konsultativ për NMVM-të është organ këshillimor dhe transparence, që ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e ekonomisë, me përfaqësues nga organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.

2. Këshilli kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe përbëhet nga 11 anëtarë me eksperiencë pune jo më pak se 10 vjet në fushën e ekonomisë dhe në mbështetjen e zhvillimit të biznesit si më poshtë:

a) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë;

b) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen e sipërmarrjes;

c) 1 përfaqësues nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;

ç) 1 përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;

d) 3 përfaqësues të sipërmarrjes dhe biznesit, të përzgjedhur nga organizatat dhe dhomat më të përfaqësuara të tregtisë dhe biznesit;

dh) 1 përfaqësues nga Shoqata e Bankave;

e) 2 përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, nga të cilët një përfaqësues nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe një përfaqësues nga institucionet jopublike të arsimit të lartë.

Përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë propozohen nga ministri përgjegjës për arsimin pas përzgjedhjes me thirrje publike.

ë) 1 përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të propozuar nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

3. Anëtarët e Këshillit emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë pas propozimit nga institucionet apo organizatat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni për një mandat 3-vjeçar me të drejtë riemërimi një herë.

4. Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) diskuton çështjet që lidhen me mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit;

b) jep mendime dhe këshilla për mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit;

c) këshillon për mënyrën e hartimit të skemave mbështetëse për biznesin sipas parashikimeve të këtij ligji dhe Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve.

5. Rregullat e hollësishme për kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve, për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 18
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë vendimin e parashikuar në nenin 17 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë udhëzimet e përcaktuara në nenet 5 dhe 8 të këtij ligji.

Neni 19
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 21.4.2022.

VENDIM
Nr. 317, datë 18.5.2022

PËR CAKTIMIN E DITËS SË MËRKURË, DATË 25.5.2022, DITË PUSHIMI

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e ditës së mërkurë, datë 25.5.2022, ditë pushimi për punonjësit e administratë shtetërore, të institucioneve me seli në qarkun e Tiranës, me përjashtim të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, shërbimit zjarrfikës, dhe punonjësve të sistemit shëndetësor.

2. Dita e punës e datës 25.5.2022 do të zëvendësohet në një nga ditët e pushimit brenda këtij viti.

3. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 318, datë 18.5.2022

PËR KALIMIN TE BASHKITË DURRËS, KAVAJË DHE KRUJË TË OBJEKTEVE ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te bashkitë Durrës, Kavajë dhe Krujë të 7 (shtatë) objekteve arsimore, sipas listave të inventarit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Durrës, Kavajë dhe Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Të dhënat e përmbledhura për objektet arsimore (tabela nr. 1)

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e ndërhyrjes	Financimi i ndërtimit	Sipërfaqe (m²)	Vlera e projektidesë	Vle e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e mbikëqyrësit	Vlera e koaludimit	Vlera totale e objektit
13	Bashkia Krujë	Krujë	Fushë-Krujë	9-vjeçare	Larush Hajdar Hoxha	Ndërtim	Buxhet GoA	2,728.0	938,836.84	100,178,330.74	813,352.42	176,237.95	102,106,757.96
14	Bashkia Krujë	Krujë	Fushë-Krujë	9-vjeçare	Gjon Luka Luz	Ndërtim	Buxhet GoA	2,375.0	710,688.42	87,215,372.26	708,105.58	153,432.97	88,787,599.22
							TOTAL	*5,103.0*	*1,649,525.3*	*187,393,703.0*	*1,521,458.0*	*329,670.9*	*190,894,357.2*

Të dhënat e përmbledhura për objektet arsimore (tabela nr. 1)

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e ndërhyrjes	Financimi i ndërtimit	Sipërfaqe (m²)	Vlera e projektidesë	Vle e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e mbikëqyrësit	Vlera e koaludimit	Vlera totale e objektit
15	Bashkia Krujë	Krujë	Thumanë	9-vjeçare + kopsht	Ramazan Jangozi	Ndërtim	Buxhet GoA	1,867.0	753,343.41	80,502,541.32	678,715.08	120,614.46	82,055,214.26
16	Bashkia Krujë	Krujë	Thumanë	9-vjeçare + kopsht	Kastrioti Derven	Ndërtim	Buxhet GoA	1,662.0	670,624.93	71,663,215.68	604,190.92	107,370.77	73,045,402.31
							TOTAL	*3,529.0*	*1,423,968.3*	*152,165,757.0*	*1,282,906.0*	*227,985.2*	*155,100,616.6*

Të dhënat e përmbledhura për objektet arsimore (tabela nr. 1)

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e ndërhyrjes	Financimi i ndërtimit	Sipërfaqe (m²)	Vlera e projektidesë	Vle e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e mbikëqyrësit	Vlera e koaludimit	Vlera totale e objektit
2	Bashkia Durrës	Durrës	Durrës	kopsht	Met Hasa	Ndërtim	Buxhet GoA	922.0	317,304.83	38,275,151.59	335,230.25	36,647.88	38,964,334.55
							TOTAL	*922.0*	*317,304.8*	*38,275,151.6*	*335,230.3*	*36,647.9*	*38,964,334.5*

Të dhënat e përmbledhura për objektet arsimore (tabela nr. 1)

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e ndërhyrjes	Financimi i ndërtimit	Sipërfaqe (m²)	Vlera e projektidesë	Vle e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e mbikëqyrësit	Vlera e koaludimit	Vlera totale e objektit
29	Qarku Tiranë	Kavajë	Helmes	9-vjeçare	Shtodher	Ndërtim	Buxhet GoA	1,689.0	548,797.30	66,383,851.72	738,282.57	66,168.31	67,737,099.90
30	Qarku Tiranë	Kavajë	Kavajë	profesionale	26 Mars	Ndërtim	Buxhet GoA	3,630.0	1,179,475.54	142,672,221.28	1,586,717.43	142,208.98	145,580,623.22
							TOTAL	*5,319.0*	*1,728,272.8*	*209,056,073.0*	*2,325,000.0*	*208,377.3*	*213,317,723.1*

VENDIM
Nr. 319, datë 18.5.2022

PËR KALIMIN TE BASHKITË SHIJAK, KAMZË, KAVAJË DHE KRUJË TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë të 272 (dyqind e shtatëdhjetë e dy) njësive individuale të banimit, përkatësisht, sipas listave të inventarit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, detajuar, si më poshtë vijon:

a) Bashkia Shijak 27 (njëzet e shtatë) njësi individuale banimi;

b) Bashkia Kamzë 29 (njëzet e nëntë) njësi individuale banimi;

c) Bashkia Kavajë 15 (pesëmbëdhjetë) njësi individuale banimi;

ç) Bashkia Krujë 201 (dyqind e një) njësi individuale banimi.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Listë inventari – 27 banesa individuale (paketa A), Bashkia Shijak									
Nr.	**ID**	**Emër Mbiemër**	**Tipologjia**	**Sip. (m²)**	**Bashkia**	**Njësia Admin.**	**Vlera e objektit (lek)**	**Vlera e mbikëqyrjes (lek)**	**Vlera e kolaudimit (lek)**
1	308	Lutfi FEIM Feimi	2+1	80.00	Shijak	Shijak	2,470,000.00	17,395.90	1,897.80
2	309	Haxhi REMZI Dino	1+1	70.00	Shijak	Shijak	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80
3	327	Alban SELAMI Vezi	2+1	80.00	Shijak	Shijak	2,470,000.00	17,395.90	1,897.80
4	328	Selami RIZA Vezi	1+1	70.00	Shijak	Shijak	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80
5	371	Bashkim ZENEL Seiti	1+1	70.00	Shijak	Shijak	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80
6	385	Bujar QAZIM Stafa	2+1	80.00	Shijak	Shijak	2,470,000.00	17,395.90	1,897.80
7	430	Shahin ABDULLA Manjani	2+1	80.00	Shijak	Shijak	2,470,000.00	17,395.90	1,897.80
8	441	Ali BAJRAM Smoqi	3+1	105.10	Shijak	Shijak	3,090,000.00	17,395.90	1,897.80
9	464	Ali IMER Milaqi	3+1	105.10	Shijak	Gjepalaj	3,090,000.00	17,395.90	1,897.80
10	471	Seid DALIP Çelbeqiri	3+1	105.10	Shijak	Gjepalaj	3,090,000.00	17,395.90	1,897.80
11	505	Dylaver ISMAIL Shahini	1+1	70.00	Shijak	Gjepalaj	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80
12	512	Frederika STAVRI Nako	1+1	70.00	Shijak	Gjepalaj	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80
13	516	Flamur SELIM Sauqeti	3+1	105.10	Shijak	Gjepalaj	3,090,000.00	17,395.90	1,897.80
14	526	Fatbardhë FADIL Biba	2+1	80.00	Shijak	Gjepalaj	2,470,000.00	17,395.90	1,897.80
15	L3.62/1	Rogert Driza	2+1	80.00	Shijak	Gjepalaj	2,470,000.00	17,395.90	1,897.80
16	L3.137	Tahir Driza	2+1	80.00	Shijak	Gjepalaj	2,470,000.00	17,395.90	1,897.80
17	345	Dashamir ZYDI Tepshi	1+1	70	Shijak	Shijak	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80
18	351	Gazmir ZYBER Domi	3+1	105.1	Shijak	Shijak	3,090,000.00	17,395.90	1,897.80
19	496	Skender QERIM Plaku	2+1	80	Shijak	Gjepalaj	2,470,000.00	17,395.90	1,897.80
20	521	Ilir ISMAIL Stafa	3+1	105.1	Shijak	Gjepalaj	3,090,000.00	17,395.90	1,897.80
21	555/1	Qerim Çali	3+1	105.1	Shijak	Gjepalaj	3,090,000.00	17,395.90	1,897.80
22	326	Xhehari TAHIR Tafa	1+1	70	Shijak	Shijak	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80
23	484	Dervish AVDI Tusha	1+1	70	Shijak	Gjepalaj	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80
24	369	Besnik ASLLAN Deliallisi	1+1	70	Shijak	Shijak	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80
25	396	Zenepe HAKI Dakavelli	3+1	105.1	Shijak	Shijak	3,090,000.00	17,395.90	1,897.80
26	L3.62	Gëzim Driza 2 persona	1+1	70	Shijak	Gjepalaj	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80
27	L3.98	Naim Driza	1+1	70	Shijak	Gjepalaj	2,095,000.00	17,395.90	1,897.80

Listë inventari – 29 banesa individuale (paketa E) , Bashkia Kamzë									
Nr.	ID.	Kryefamiljari	Tipologjia e banesës	Sipërfaqe (m^2)	Bashkia	Njësia Administrative	Vlera e objektit (lek)	Vlera e mbikëqyrjes (lek)	Vlera e kolaudimit (lek)
1	61	Shefqet Durrsi	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
2	17	Lije Peposhi	1+1	70.00	Kamzë	Bathore	2,180,000	16,319.25	1,897.80
3	28	Fetije Murati	1+1	70.00	Kamzë	Paskuqan	2,180,000	16,319.25	1,897.80
4	36	Riza Tafhasi	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
5	76	Avni Hoxha	1+1	70.00	Kamzë	Kamzë	2,180,000	16,319.25	1,897.80
6	5	Mujo Mema	2+1	80.00	Kamzë	Bathore	2,500,000	16,319.25	1,897.80
7	10	Shahin Prençi	2+1	80.00	Kamzë	Bathore	2,500,000	16,319.25	1,897.80
8	131	Bukurie Peca	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
9	63	Tomorr Domi	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
10	72	Tahir Mata	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
11	85	Luan Puci	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
12	98	Besnik Kotarja	3+1	105.10	Kamzë	Bathore	3,170,000	16,319.25	1,897.80
13	115	Krenar Mujo	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
14	126	Lazime Cala	1+1	70.00	Kamzë	Paskuqan	2,180,000	16,319.25	1,897.80
15	128	Ferbim Billa	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
16	83	Ylli Burreli	1+1	70.00	Kamzë	Kamzë	2,180,000	16,319.25	1,897.80
17	137	Ferit Driza	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
18	139	Musa Vladi	1+1	70.00	Kamzë	Paskuqan	2,180,000	16,319.25	1,897.80
19	144	Miftar Lleshi	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
20	149	Qemal Sina	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
21	154	Shaban Driza	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
22	155	Kliton Koka	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
23	157	Vladimir Lala	1+1	70.00	Kamzë	Paskuqan	2,180,000	16,319.25	1,897.80
24	161	Beqir Allaraj	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
25	168	Stefan Laçi	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
26	171	Dalip Lalo	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
27	174	Iljaz Domi	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
28	175	Mehmet Laçi	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
29	147	Mustafa Kabili	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80

Listë inventari – 77 banesa individuale (paketa B), Bashkia Krujë									
Nr.	ID.	Segmenti	Tipologjia e banesës	Sipërfaqe (m^2)	Bashkia	Njësia administrative	Vlera e objektit (lek)	Vlera e mbikëqyrjes (lek)	Vlera e kolaudimit (lek)
1	1	Segmenti 1	1+1	70.00	Krujë	Bubq	2,100,000.00	18,601.95	1,897.80
2	2	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
3	3	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
4	4	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
5	5	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
6	6	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
7	7	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
8	8	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
9	9	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
10	10	Segmenti 1	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
11	11	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
12	12	Segmenti 1	1+1	70.00	Krujë	Bubq	2,100,000.00	18,601.95	1,897.80
13	13	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
14	14	Segmenti 1	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
15	15	Segmenti 1	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
16	16	Segmenti 1	1+1	70.00	Krujë	Bubq	2,100,000.00	18,601.95	1,897.80
17	17	Segmenti 1	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
18	18	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
19	19	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
20	20	Segmenti 1	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
21	21	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
22	22	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
23	23	Segmenti 1	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
24	24	Segmenti 1	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
25	25	Segmenti 1	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
26	26	Segmenti 1	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
27	27	Segmenti 1	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
28	28	Segmenti 1	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
29	29	Segmenti 2	1+1	70.00	Krujë	Bubq	2,100,000.00	18,601.95	1,897.80
30	30	Segmenti 2	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
31	31	Segmenti 2	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80

32	32	Segmenti 2	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
33	33	Segmenti 2	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
34	34	Segmenti 2	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
35	35	Segmenti 2	1+1	70.00	Krujë	Bubq	2,100,000.00	18,601.95	1,897.80
36	36	Segmenti 2	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
37	37	Segmenti 2	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
38	38	Segmenti 2	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
39	39	Segmenti 2	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
40	40	Segmenti 2	2+1	80.00	Krujë	Bubq	2,480,000.00	18,601.95	1,897.80
41	41	Segmenti 2	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
42	42	Segmenti 2	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
43	43	Segmenti 2	3+1	105.10	Krujë	Bubq	3,100,000.00	18,601.95	1,897.80
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 328, datë 18.5.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1088, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE TË PROCEDURAVE TË REGJISTRIMIT E PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE PËR PRONARËT PËRFITUES, SI DHE TË NJOFTIMIT NGA AUTORITETET SHTETËRORE KOMPETENTE DHE NGA SUBJEKTET E DETYRUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, 6, pikat 8, 9, e 10, dhe 15, pika 4, të ligjit nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1088, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I, "DISPOZITA TË PËRGJITHSHME", bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas shkronjës "c", të pikës 1, shtohen shkronjat "ç" dhe "d", me këtë përmbajtje:

"ç) "Regjistrim fillestar" është regjistrimi për herë të parë i pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, në përputhje me parashikimet e ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

d) "Regjistrim i ndryshimeve" është regjistrimi i çdo ndryshimi faktik të personit të regjistruar më parë si pronar përfitues, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues (zëvendësimi, shtimi i një personi të ri apo heqja e një personi nga regjistri i pronarëve përfitues), si dhe regjistrimi i çdo ndryshimi tjetër në të dhënat e regjistruara të pronarëve përfitues.".

b) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"2. Kërkesa për regjistrimin fillestar, regjistrimin e ndryshimeve apo përditësimin e të dhënave të pronarëve përfitues bëhet sipas afateve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 5, të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

3. Kërkesa për regjistrimin fillestar, regjistrimin e ndryshimeve apo përditësimin e të dhënave të pronarëve përfitues paraqitet nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, në përputhje me parashikimet e kreut II, të këtij vendimi.".

2. Në kreun II, "PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN E TË DHËNAVE NË REGJISTRIN E PRONARËVE PËRFITUES", bëhen disa ndryshime:

a) Pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"1. Kërkesa për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, që regjistrohen në regjistrin tregtar, paraqitet nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni që rregullon procedurat e regjistrimit fillestar të personit juridik në regjistrin tregtar.

2. Kërkesa për kryerjen e të gjitha regjistrimeve të tjera sipas këtij vendimi paraqitet nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues, duke u identifikuar elektronikisht në sportelin elektronik të QKB-së nëpërmjet autentifikimit nga portali unik i shërbimeve qeveritare *"e-Albania"*. Pas këtij autentifikimi, personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues akseson sportelin elektronik dhe zgjedh llojin e regjistrimit që kërkohet të kryhet. Pas përzgjedhjes së llojit të regjistrimit, sistemi i informatizuar shfaq formularin përkatës të kërkesës, sipas formatit të miratuar, dhe hap dosjen elektronike, e cila mban numrin përkatës (një numër për çdo dosje ose aplikim), të dhënë nga sistemi i informatizuar (numri i çështjes).".

b) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Për plotësimin e të metave në rastin e pezullimit të një kërkese të paraqitur për regjistrim fillestar, të ndryshimeve apo përditësimit të të dhënave të pronarëve përfitues, zbatohen procedurat e parashikuara sipas këtij kreu.".

3. Në kreun III, "DOKUMENTACIONI DHE FORMA E KËRKUAR", bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 1 bëhen disa ndryshime:

i. Nënndarjet "iii" dhe "iv", të shkronjës "a", ndryshohen, si më poshtë vijon:

"iii. dokumentacionin e autoritetit kompetent regjistrues, që vërteton se pronari përfitues i regjistruar është zotërues i 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit, të të

drejtave të votimit ose të interesave të pronësisë, si dhe që përmban datën e përcaktimit si pronar përfitues; dhe

iv. çdo dokumentacion tjetër që zotëron subjekti raportues për identifikimin dhe regjistrimin e pronarit, përfitues të tij, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, përfshirë datën e përcaktimit si pronar përfitues, nëse ky informacion nuk rezulton në dokumentacionin sipas nënndarjes "iii" të kësaj shkronje.".

ii. Nënndarjet "iii" dhe "iv", të shkronjës "b", ndryshohen, si më poshtë vijon:

"iii. dokumentacionin e autoritetit kompetent regjistrues, që vërteton se pronari përfitues i regjistruar është zotërues i 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit, të të drejtave të votimit ose të interesave të pronësisë, si dhe që përmban datën e përcaktimit si pronar përfitues; dhe

iv. çdo dokumentacion tjetër që zotëron subjekti raportues për identifikimin dhe regjistrimin e pronarit përfitues të tij, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, përfshirë datën e përcaktimit si pronar përfitues, nëse ky informacion nuk rezulton në dokumentacionin sipas nënndarjes "iii" të kësaj shkronje.".

iii. Shkronjat "c" dhe "ç" ndryshohen, si më poshtë vijon:

"c) Dokumentacioni i përcaktuar në nënndarjet "i" dhe "iii", të shkronjës "a", të kësaj pike, duhet të jetë hartuar brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues.

ç) Dokumentacioni i përcaktuar në nënndarjet "i" dhe "iii", të shkronjës "b", të kësaj pike, duhet të jetë hartuar brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave të pronarëve përfitues.".

iv. Paragrafi i dytë, i shkronjës "dh", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Deklarata me shkrim e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, e përcaktuar në këtë shkronjë, duhet të jetë hartuar brenda afateve të kërkuara për dokumentet e tjera të përcaktuara sipas shkronjës "a" ose shkronjës "b", të pikës 1, të këtij kreu.".

v. Paragrafi i dytë, i shkronjës "ë", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Deklarata me shkrim e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit raportues, e përcaktuar në këtë shkronjë, duhet të jetë hartuar brenda afateve të kërkuara për dokumentet e tjera të përcaktuara sipas shkronjës "a" ose shkronjës "b", të pikës 1, të këtij kreu.".

b) Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

"6. Në rastin e një kërkesë sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, paraqitet i njëjti dokumentacion i kërkuar sipas parashikimeve të mësipërme të këtij kreu, me përjashtim të dokumentacionit, që vërteton numrin unik të identifikimit së bashku me datën e regjistrimit të subjektit në regjistrin tregtar, si dhe ekstraktin e të dhënave të regjistruara të subjektit raportues, të lëshuar sipas legjislacionit përkatës që rregullon procedurat e regjistrimit në regjistrin tregtar. Dokumentet e kërkuara në lidhje me këtë kërkesë paraqiten në të njëjtat mënyra dhe në të njëjtin format me dokumentacionin e kërkuar sipas legjislacionit përkatës që rregullon procedurat e regjistrimit në regjistrin tregtar.".

4. Në kreun IV, "PROCEDURA E VLERËSIMIT TË APLIKIMIT DHE ARSYET E REFUZIMIT PËR REGJISTRIMIN E TË DHËNAVE TË PRONARËVE PËRFITUES TË SUBJEKTEVE RAPORTUESE", bëhen disa ndryshime dhe shtesa:

a) Titulli i kreut ndryshohet dhe zëvendësohet me:

"IV. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KËRKESËS DHE ARSYET E PEZULLIMIT APO REFUZIMIT PËR REGJISTRIMIN E TË DHËNAVE TË PRONARËVE PËRFITUES TË SUBJEKTEVE RAPORTUESE".

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura sipas parashikimeve të krerëve II e III, të këtij vendimi, merren në shqyrtim nga nëpunësit e autorizuar të QKB-së për vendimmarrje, sipas radhës së paraqitjes së tyre.".

c) Në pikën 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Shkronja "dh", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"dh) faktin nëse janë shlyer sanksionet administrative të zbatuara, sipas parashikimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.".

ii. Pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "e", me këtë përmbajtje:

"e) faktin nëse të dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme, sipas dispozitave të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.".

ç) Pikat 5, 6, 7, 8 dhe 9 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"5. Nëse nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së, pas verifikimeve sipas pikave të sipërpërmendura, vëren se kërkesa është në përputhje me parashikimet e ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues dhe të këtij vendimi:

a) në rastin e një kërkese të paraqitur sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, miraton kërkesën njëkohësisht me regjistrimin e subjektit raportues si person juridik në regjistrin tregtar;

b) në rastet e një kërkese të paraqitur sipas pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, miraton kërkesën jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga paraqitja e saj.

6. Nëse nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së, pas verifikimeve sipas pikave të sipërpërmendura, vëren se kërkesa nuk është në përputhje me parashikimet e ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues dhe të këtij vendimi:

a) në rastin e një kërkesë të paraqitur sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, jo më vonë se 1 (një) ditë pune nga marrja e kërkesës, pezullon veprimet për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues të subjektit raportues. Pezullimi i veprimeve sipas kësaj pike përbën shkak për pezullimin e procedurave të regjistrimit fillestar të personit juridik në regjistrin tregtar. Plotësimi i të metave që pengojnë regjistrimin kryhet nga subjekti raportues brenda afateve dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi që rregullon procedurat e regjistrimit në regjistrin tregtar si dhe me parashikimet e kreut III, të këtij vendimi. Mosplotësimi i të metave që pengojnë regjistrimin në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas këtij vendimi, nga subjekti raportues me pronësi direkte përbën shkak për refuzimin e aplikimit për regjistrimin e personit juridik në regjistrin tregtar sipas legjislacionit përkatës;

b) në rastin e një kërkese të paraqitur sipas pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, jo më vonë se 2 (dy) ditë pune nga marrja e kërkesës, pezullon veprimet për regjistrimin e kërkesës dhe QKB-ja e njofton subjektin raportues sipas kreut VII, të këtij vendimi, për shkakun e saktë të pezullimit. Plotësimi i të metave që pengojnë regjistrimin kryhet nga subjekti raportues brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, në përputhje me parashikimet e krerëve II dhe III, të këtij vendimi.

7. Në rastet e pezullimit të veprimeve sipas pikës 6, të këtij kreu, nëse subjekti raportues plotëson të metat që pengojnë regjistrimin, brenda afateve përkatëse, nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së miraton kërkesën sipas pikës 5, të këtij kreu. Në këto raste, regjistrimi mban datën e paraqitjes së kërkesës së parë.

8. Nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) i QKB-së refuzon kërkesën si vijon:

a) njëkohësisht me refuzimin e aplikimit për regjistrimin e personit juridik në regjistrin tregtar sipas legjislacionit përkatës, në rastin e një kërkese të paraqitur sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, nga një subjekt me pronësi direkte;

b) jo më vonë se 2 (dy) ditë pune pas përfundimit të afatit të përcaktuar sipas shkronjës "a", të pikës 6, të këtij kreu, nëse subjekti raportues me pronësi indirekte nuk plotëson të metat që pengojnë regjistrimin, në rastin e një kërkesë të paraqitur sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi;

c) jo më vonë se 2 (dy) ditë pune pas përfundimit të afatit të përcaktuar sipas shkronjës "b", të pikës 6, të këtij kreu, nëse subjekti raportues nuk plotëson të metat që pengojnë regjistrimin, në rastin e një kërkese të paraqitur sipas pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi;

ç) jo më vonë se 2 (dy) ditë pune pas paraqitjes së kërkesës, nëse të dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme, sipas dispozitave të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

9. Me refuzimin e një kërkese, subjektet raportuese kanë të drejtë të riaplikojnë, sipas ligjit dhe këtij vendimi, paraqitja e së cilës trajtohet si kërkesë e re. Paraqitja e një kërkesë të re nuk çliron subjektin raportues nga sanksionet e parashikuara sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, në lidhje me moskryerjen e regjistrimeve të detyrueshme brenda afateve ligjore.".

5. Pika 1, e kreut VII, "DISPOZITA PËR NJOFTIMIN E VENDIMEVE", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Çdo vendim i QKB-së në lidhje me miratimin, pezullimin apo refuzimin e një kërkese njoftohet nëpërmjet publikimit në regjistër. Data e njoftimit është data e publikimit në regjistër. Në

rastin e një kërkese për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, që regjistrohen në regjistrin tregtar, njoftimi bëhet nga QKB-ja, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi që rregullon procedurat e regjistrimit në regjistrin tregtar.".

6. Pas kreut VIII, "AKSESI NË REGJISTRIN E PRONARIT PËRFITUES DHE TË DHËNAT E TIJ", shtohet kreu IX, me këtë përmbajtje:

"IX. DISPOZITA TRANSITORE

1. Regjistrimi fillestar i të dhënave për pronarët përfitues nga subjektet raportuese ekzistuese, të regjistruara në regjistrin tregtar me pronësi direkte, kryhet sipas pikave 2–5, të këtij kreu.

2. QKB-ja identifikon subjektet raportuese ekzistuese të regjistruara në regjistrin tregtar me pronësi direkte, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 6/2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, 'Për regjistrin e pronarëve përfitues'", të ndryshuar, nuk kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar të pronarëve të tyre përfitues.

3. QKB-ja, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, brenda datës 30.6.2022, transferon nga baza e të dhënave ekzistuese në Regjistrin Tregtar në regjistrin e pronarëve përfitues të dhënat e pronarëve përfitues që identifikohen sipas përcaktimeve ligjore, në lidhje me subjektet e përcaktuara sipas pikës 2 të këtij kreu.

4. Detyrimi për regjistrimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet e përcaktuara sipas pikës 2, të këtij kreu, quhet i përmbushur në datën e transferimit në regjistrin e pronarëve përfitues të të dhënave të pronarëve të tyre përfitues sipas pikës 3 të këtij kreu.

5. Subjektet e përcaktuara sipas pikës 2, të këtij kreu, kanë të drejtë të përditësojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues, që janë transferuar në regjistrin e pronarëve përfitues sipas pikës 3 të këtij kreu, duke paraqitur kërkesë sipas parashikimeve të kreut II, të këtij vendimi. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga këto subjekte për herë të parë, pas transferimit të të dhënave në regjistrin e pronarëve përfitues, nuk zbatohen kundërvajtje administrative.

6. Subjektet raportuese, të regjistruara në Regjistrin Tregtar me pronësi indirekte, si dhe subjektet raportuese të regjistruara në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 6/2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 112/2020, 'Për regjistrin e pronarëve përfitues'", të ndryshuar, nuk kanë përmbushur detyrimin për regjistrimin fillestar apo për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave të pronarëve të tyre përfitues, duhet t'i përmbushin këto detyrime brenda datës 30.6.2022, duke paraqitur kërkesë, në përputhje me parashikimet e kreut II, të këtij vendimi.

7. Ndaj subjekteve raportuese, që, brenda datës 30.6.2022, nuk përmbushin detyrimet sipas pikës 6, të këtij kreu, QKB-ja zbaton gjobën e parashikuar nga pika 4, e nenit 15/1, të ligjit nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar.

8. Subjektet raportuese ekzistuese, të regjistruara në Regjistrin Tregtar me pronësi indirekte, si dhe ato të regjistruara në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse ekzistuese, që rezultojnë me status të pezulluar, regjistrojnë pronarin përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, përpara kërkesës për ndryshimin e statusit të tyre në Regjistrin Tregtar apo në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse ekzistuese. Ndryshimi i statusit të këtyre subjekteve raportuese ekzistuese në Regjistrin Tregtar apo në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse bëhet pas verifikimit të kryerjes së regjistrimit të pronarit përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues.".

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, QKB-ja, autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse, dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 329, datë 18.5.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për shpërblimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit Rregullator Hekurudhor përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti Rregullator Hekurudhor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TABELA

Emërtesa e Bordit/Këshillit/ Komisionit	Numri maksimal i pagesave për një vit	Përbërja		Masa e shpërblimit në lekë	
Këshilli Drejtues i Autoritetit Rregullator Hekurudhor	10	Kryetari	Nr. i anëtarëve	15,000	10,000
		1	4		

VENDIM
Nr. 330, datë 18.5.2022

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin "Shpenzime korrente", në artikullin 604 "Të tjera transferta korrente të brendshme", të programit buxhetor "Zhvillimi i sportit", i shtohet fondi prej 160 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, për financimin e veprimtarisë së federatave sportive dhe shpërblimin e sportistëve elitarë.

2. Efekti financiar, prej 160 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 331, datë 18.5.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 24, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT E ORGANIZIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 17, të ligjit nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", dhe të nenit 6, të ligjit nr. 89/2014, "Për pajisjet mjekësore", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 24, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) në pikën 1, fjalët "... sipas strukturës që i bashkëlidhet këtij vendimi ..." zëvendësohen me "... sipas strukturës dhe organikës, të përcaktuara në skemat 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi ...";

b) pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

"5.1 Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.";

c) shkronja "c", e pikës 7, shfuqizohet;

ç) shkronja "dh", e pikës 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"dh) miraton përshkrimet e punës për të gjithë punonjësit e Agjencisë.";

d) skemat 1 dhe 2 zëvendësohen me skemat me të njëjtin numër e titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SKEMA 1

STRUKTURA E AGJENCISË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE



SKEMA 2

ORGANIKA E AGJENCISË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE

POZICIONI	NUMRI
I. DREJTOR	**1**
II. ZV/DREJTOR TEKNIK	1
III. ZV/DREJTOR EKONOMIK	1
IV. KOORDINATOR I RRJETIT TË KOORDINATORËVE KUNDËR KORRUPSIONIT	1
V. SEKTORI I PAJISJEVE MJEKËSORE	**5**
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST/MJEK/INXHINIER	4
VI. SEKTORI I FARMAKOVIGJILENCËS	**5**
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST/MJEK	4
VII. SEKTORI I AUTORIZIMIT PËR TREGTIM & ÇËSHTJEVE RREGULLATORE	**12**
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST	9
MJEK	2
VIII. SEKTORI I SHPËRNDARJES SË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE	**8**
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST INSPEKTOR PËR KONTROLLIN FARMACEUTIK	4
SPECIALIST	2
TEKNIK I MESËM	1
IX. SEKTORI I INSPEKTIMIT	**21**
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST INSPEKTOR PËR KONTROLLIN FARMACEUTIK	16
MJEK/INXHINIER PËR PAJISJET MJEKËSORE (PËR INSPEKTIMIN E PAJISJEVE MJEKËSORE)	4
X. LABORATORI I KONTROLLIT	**19**
SHEF SEKTORI	1
ANALIST	14
LABORANT	4
XI. SEKTORI I INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT	**4**
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST/MJEK	3
XII. SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE	**6**
SHEF SEKTORI	1
SPECIALIST (JURIST)	1
SPECIALIST (PËR BURIMET NJERËZORE & MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN)	1
ARKIVIST	1
PROTOKOLLIST	1
NËPUNËS INFORMACIONI	1
XIII. SEKTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE	**3**
SHEF SEKTORI	1
SPECIALIST (JURIST)	2
XIV. SEKTORI I FINANCËS & SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	**12**
SHEF SEKTORI	1
SPECIALIST (EKONOMIST)	3
MAGAZINIER	1
SHOFER	3
SANITAR	3
PUNONJËS MIRËMBAJTJEJE	1
PUNONJËS GJITHSEJ	**99**

VENDIM
Nr. 332, datë 18.5.2022

PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONIT PËRGJEGJËS PËR MBIKËQYRJEN DHE KONTROLLIN E PRODHIMIT, IMPORTIMIT, EKSPORTIMIT, RUAJTJES, TREGTIMIT DHE PËRDORIMIT TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 17/2020, "Për produktet plehëruese", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese.
2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 333, datë 18.5.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 113, DATË 17.2.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT UDHËZUES TË POLITIKAVE MBI ZONAT E PËRCAKTUARA PËR AKUAKULTURË (ZPA) NË SHQIPËRI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 103/2016, "Për akuakulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në dokumentin udhëzues të politikave mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri, bashkëlidhur vendimit nr. 113, datë 17.2.2021, të Këshillit të Ministrave, dhe pjesëve përbërëse të tij, tabela 2 dhe figura nr. 1 zëvendësohen përkatësisht me tabelën 2 dhe figurën nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela 2. *Koordinatat e ZPA_SAR_F01_01*

	Gjerësia gjeografike	**Gjatësia gjeografike**
1	39°57'59.57"N	19°52'0.19"E
2	39°58'16.25"N	19°52'49.27"E
3	39°56'20.97"N	19°53'47.91"E
4	39°56'02.59"N	19°52'59.32"E

Figura nr. 1. *Identifikimi i kategorisë 01 të ZPA – peshqit në zonën e Sarandës*



UDHËZIM
Nr. 11, datë 16.5.2022

PËR CERTIFIKIMIN E HARTUESVE TË TESTEVE DHE VLERËSUESVE TË PROVIMEVE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 26 dhe të pikës 3, të nenit 49, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. KRITERET PËR HARTUESIT E TESTEVE DHE VLERËSUESIT E PROVIMEVE KOMBËTARE

1. Kandidati për hartimin e testeve dhe vlerësuesi në provimet kombëtare është mësuesi, që:

a) ushtron profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi;

b) ka të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune si mësues për hartuesit dhe 5 (pesë) vjet përvojë pune si mësues për vlerësuesit;

c) ka dhënë lëndën përkatëse të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e nivelit arsimor;

ç) ka të paktën kategorinë e kualifikimit "mësues i kualifikuar", dhe është vlerësuar në provimin e kualifikimit të mësuesve me "Shumë mirë" për hartuesit e testeve dhe të paktën "mirë" për vlerësuesit e testeve;

d) preferohet të ketë përvojë në hartimin e pyetjeve për provimet kombëtare.

II. DETYRAT E QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

1. Qendra e Shërbimeve Arsimore (në vijim "QSHA"), publikon në adresën elektronike zyrtare shpalljen e interesit për hartues të provimeve kombëtare dhe vlerësues të testeve të provimeve të Maturës Shtetërore.

2. Shpallja e interesit nga QSHA-ja duhet të përmbajë kriteret që duhet te plotësojë hartuesi i testeve të provimeve kombëtare dhe vlerësuesi i testeve të provimeve të Maturës Shtetërore.

3. Pas publikimit të shpalljes së interesit, për hartues të testeve të provimeve kombëtare dhe vlerësues të testeve të provimeve të Maturës Shtetërore, në adresën elektronike zyrtare të QSHA, secili kandidati i interesuar plotëson formularin e aplikimit dhe dërgon zyrtarisht në QSHA dokumentacionin e kërkuar.

4. Kandidati për hartues i testeve të provimeve kombëtare dhe vlerësues i testeve të provimeve të Maturës Shtetërore paraqet në QSHA, dokumentacionin si më poshtë:

a) jetëshkrimin;

b) 2 (dy) rekomandime nga drejtues të shkollave ose zyrës vendore të arsimit parauniversitar (në vijim "ZVAP");

c) fotokopje të noterizuar të librezës së punës;

ç) kopje e dëshmisë së provimit të kualifikimit.

5. Kandidati për hartues i testeve të provimeve kombëtare dhe vlerësues i testeve të provimeve të Maturës Shtetërore merr pjesë në programin e trajnimit që realizohet nga QSHA-ja.

6. Kandidati për hartues i testeve të provimeve kombëtare dhe vlerësues i testeve të provimeve të Maturës Shtetërore, pas përfundimit të programit të trajnimit i nënshtrohet provimit me test, të hartuar nga QSHA-ja. Nëse rezulton kalues në provim, pajiset me certifikatën përkatëse.

7. QSHA-ja publikon në adresën zyrtare elektronike:

a) materiale që lidhen me hartimin dhe vlerësimin e testeve;

b) datat e zhvillimit të programeve të trajnimit;

c) datat dhe vendin e zhvillimit të provimeve.

8. QSHA-ja miraton rregulloren që përshkruan procedurat e zhvillimit të provimit, të vlerësimit të kandidatëve në provim, si dhe formatin e përmbajtjes së certifikatës së lëshuar nga ana e saj.

9. Të gjithë vlerësuesit e testeve të maturës shtetërore, të cilët janë pajisur me certifikatë nga QSHA-ja, kanë të drejtë të përfshihen në vlerësimin e testeve të maturës shtetërore. Numri i tyre do të përcaktohet në varësi të nevojave të QSHA-së.

10. Nga hartuesit e fondit të pyetjeve të maturës shtetërore, të pajisur me certifikatë nga QSHA-ja për çdo vit me urdhër të QSHA-së përzgjidhen jo më pak se 5 (pesë) hartues, për secilën lëndë të provimeve të maturës shtetërore.

III. DETYRAT E ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

1. ZVAP-ja publikon në adresën elektronike zyrtare shpalljen e interesit për vlerësues të testeve të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor.

2. Shpallja e interesit nga ZVAP-ja duhet të përmbajë kriteret që duhet te plotësojë vlerësuesi i testeve të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor.

3. Kandidati për vlerësues i testeve të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor paraqet në ZVAP, dokumentacionin sa më poshtë:

a) jetëshkrim;

b) 2 (dy) rekomandime nga drejtues të shkollave ose ZVAP-ja;

c) një fotokopje të noterizuar të librezës së punës;

ç) kopje të dëshmisë së provimit të kualifikimit.

4. Kandidati për vlerësues i testeve të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor merr pjesë në programin e trajnimit që realizohet nga ZVAP-ja.

5. Kandidati për vlerësues i testeve të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, pas përfundimit të programit të trajnimit i nënshtrohet provimit me test, të hartuar nga ZVAP-ja. Nëse rezulton kalues në provim, pajiset me certifikatën përkatëse.

6. Të gjithë vlerësuesit e testeve të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor, të cilët janë pajisur me certifikatë nga ZVAP-ja, përfshihen në vlerësimin e këtyre testeve.

7. ZVAP-ja publikon në adresën zyrtare elektronike:

a) materiale që lidhen me hartimin dhe vlerësimin e testeve;

b) datat e zhvillimit të programeve të trajnimit;

c) datat dhe vendin e zhvillimit të provimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar miraton rregulloren që përshkruan procedurat e zhvillimit të provimit, të vlerësimit të kandidatëve në provim, si dhe formatin e përmbajtjes së certifikatës së lëshuar nga ana ZVAP-së.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pagesa e hartuesve të provimeve kombëtare dhe vlerësuesve të testeve të provimeve të Maturës Shtetërore do të kryhet nga QSHA-ja, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

2. Pagesa e vlerësuesve të testeve të provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe të vlerësuesve të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor do të kryhet nga ZVAP-ja, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

3. Udhëzimi nr. 24, datë 2.8.2013, "Për certifikimin e hartuesve të testeve dhe vlerësuesve në provimet kombëtare", shfuqizohet.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat arsimore vendore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

KËRKESË
Nr. 135/4, datë 17.5.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimet shpall kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor *'By Pass* Fier"', të ndryshuar.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, sipas tabelës bashkëlidhur kësaj kërkese.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat, të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 24,278,233 (njëzet e katër milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1056, DATË 14.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT *BY PASS* FIER"

NR.	PRONARI			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqe e shpronësuar	Çmimi lekë/m²	Vlera totale (lek)	Adresat	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Bashkëpronësi Haxha, Kacani			3980	16/56	197	Arë	197	684	**134,748**	MB-Ferko	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Arber, Sibora	Resmi	Ferko	3980	16/39	360	Arë	97	684	**66,348**	MB-Ferko	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Arber, Sibora	Resmi	Ferko	3980	16/31	385	Arë	100	684	**68,400**	MB-Ferko	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Arber, Sibora		Ferko	3980	16/28	960	Arë	193	684	**132,012**	MB-Ferko	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Shaban	Ali	Xhaxha	3980	16/47	136	Arë	136	684	**93,024**	MB-Ferko	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Izet	Ali	Xhaxha	3980	16/54	65	Arë	65	684	**44,460**	MB-Ferko	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Zaho	Servet	Hodaj	2436	538/36	3200	Arë	355	335	**118,925**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	Paskal	Llaqi	Ristani	2436	537/42	7260	Arë	2609	335	**874,015**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	Marino	Arbem	Halimi	2436	538/31	6430	Arë	144	335	**48,240**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Alush	Beqir	Vernozi	3436	58/50	2584	Arë	39	299	**11,661**	Shtyllas	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	Bashkëpronarët Profka, Doresi, Pocaj			3436	58/45	2310	Arë	1700	299	**508,300**	Shtyllas	Konfirmuar nga ASHK-ja
12	Dritan	Pellumb	Baruti	3436	91/37	7939	Arë	53	299	**15,847**	Shtyllas	Konfirmuar nga ASHK-ja
13	Bashkëpronarët		Ndreu	3436	250/26	13400	Arë	12585	299	**3,762,915**	Shtyllas	Konfirmuar nga ASHK-ja
14	Bashkëpronarët		Mucka, Kadiu	3436	17/5	6418	Arë	5700	299	**1,704,300**	Shtyllas	Konfirmuar nga ASHK-ja
15	Bashkëpronarët		Papa	1941	82/17	3830	Arë	2186	427	**933,422**	Havaleas	Konfirmuar nga ASHK-ja
16	Bashkëpronarët		Naci, Mahmutaj, Stromi	3015	3/3	9120	Arë	534	869	**464,046**	Pojan	Konfirmuar nga ASHK-ja
17	Isuf	Gjymshit	Gashi	3015	6/15	1130	Arë	521	869	**452,749**	Pojan	Konfirmuar nga ASHK-ja
18	Fatmir	Xhevit	Veliu	2636	101/6	11693	Arë	60	437	**26,220**	MB-Ura	Konfirmuar nga ASHK-ja
19	Nikolla	Musa	Veliu	2636	73/16	6091	Arë	670	437	**292,790**	MB-Ura	Konfirmuar nga ASHK-ja
20	Agron	Hysenj	Lika	2944	129/104	1200	Arë	467	274	**127,958**	Petovë	Konfirmuar nga ASHK-ja
21	Albert	Dervish	Veliu	2636	72/8	5914	Arë	125	437	**54,625**	MB-Ura	Konfirmuar nga ASHK-ja
22	Bashkëpronarët Metaj, Rakipi, Muço, Bulla, Metushi Avdiaj, Grëmi, Thomaj			2944	129/94	2400	Arë	856	274	**234,544**	Petovë	Konfirmuar nga ASHK-ja
23	Fasllı	Jashar	Rakipi	2944	122/44	7900	Arë	562	274	**153,988**	Petovë	Konfirmuar nga ASHK-ja
24	Sadik	Jashar	Rakipi	2944	122/40	820	Arë	358	274	**98,092**	Petovë	Konfirmuar nga ASHK-ja
25	Kalem	Hysni	Kaja	2944	130/10	1476	Arë	1060	274	**290,440**	Petovë	Konfirmuar nga ASHK-ja
26	Vangjel	Todi	Profka	3436	58/44	1650	Arë	1151	299	**344,149**	Shtyllas	Konfirmuar nga ASHK-ja
27	Petref	Mesut	Murataj	3436	15/7	1980	Arë	1468	299	**438,932**	Shtyllas	Konfirmuar nga ASHK-ja
28	Bilbil	Mesut	Murataj	3436	15/6	1650	Arë	1119	299	**334,581**	Shtyllas	Konfirmuar nga ASHK-ja
29	Baftjar	Hekuran	Buzi	2636	36/45	5595	Arë	37	437	**16,169**	MB-Ura	Konfirmuar nga ASHK-ja
30	Baftjar	Hekuran	Buzi	2636	36/44	1750	Arë	75	437	**32,775**	MB-Ura	Konfirmuar nga ASHK-ja
31	Andrea	Liko	Gjeçi	1941	89/15	4050	Arë	718	427	**306,586**	Havaleas	Konfirmuar nga ASHK-ja
32	Sokrat		Tushe	1941	84/41	16300	Arë	4086	427	**1,744,722**	Havaleas	Konfirmuar nga ASHK-ja
33	Stavro	Pano	Tako	3436	58/78	990	Arë	990	299	**296,010**	Shtyllas	Konfirmuar nga ASHK-ja
34	Bajram	Xhelal	Kumaraku	3038	112/3	26000	Arë	1419	134	**190,146**	Povelç	Konfirmuar nga ASHK-ja
35	Gezim	Beqir	Vrenozi	3436	58/81	1980	Arë	1249	299	**373,451**	Shtyllas	Konfirmuar nga ASHK-ja
36	Bashkëpronarët Puka, Mavriqi, Rugova, Sina, Gashi, Kapiti			1471	45/28	700	Arë	700	699	**489,300**	Dërmenas	Konfirmuar nga ASHK-ja
37	Bashkëpronarët Xhafa, Moçka			1471	47/38	2000	Arë	422	699	**294,978**	Dërmenas	Konfirmuar nga ASHK-ja
38	Zabit	Hekuran	Xhafa	1471	47/39	2240	Arë	525	699	**366,975**	Dërmenas	Konfirmuar nga ASHK-ja
39	Flamur	Petro	Gjonaj	2436	538/59	4781	Arë	185	335	**61,975**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
40	Fuat	Qerim	Cela	1471	44/2	2700	Arë	1113	699	**777,987**	Dërmenas	Konfirmuar nga ASHK-ja
41	Qerim		Cela	1471	44/1	5600	Arë	2021	699	**1,412,679**	Dërmenas	Konfirmuar nga ASHK-ja
42	Resul	Qerim	Cela	1471	44/3	2700	Arë	1013	699	**708,087**	Dërmenas	Konfirmuar nga ASHK-ja
43	Bedri	Behar	Hoxhaj	2436	121/33	4560	Arë	611	335	**204,685**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
44	Xhemal	Riza	Hoxhaj	2436	121/30	5700	Arë	718	335	**240,530**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
45	Beqar	Sulo	Mehmetaj	2436	138/2	5700	Arë	839	335	**281,065**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
46	Nexhmedin	Osmen	Fejzulla	2436	138/1	4450	Arë	392	335	**131,320**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
47	Vllaznim		Maçedonasi	1471	10/24	300	Arë	300	699	**209,700**	Dërmenas	Konfirmuar nga ASHK-ja
48	Shaban	Myslim	Berisha	1471	43/13	8530	Arë	87	699	**60,813**	Dërmenas	Konfirmuar nga ASHK-ja
49	Taip	Hysni	Xhafa	1471	44/11	3250	Arë	49	699	**34,251**	Dërmenas	Konfirmuar nga ASHK-ja
50	Dhimiter	Vasil	Marku	2436	120/5	5700	Arë	232	335	**77,720**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja

51	Foto	Llaqi	Ristani	2436	537/41	6050	Arë	2006	335	**672,010**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
52	Vasil	Llaqi	Ristani	2436	537/43	4840	Arë	626	335	**209,710**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
53	Napolon	Bektash	Lamce	2436	121/29	4560	Arë	1270	335	**425,450**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
54	Bashkëpronarët		Hoxhaj	2436	121/31	6840	Arë	947	335	**317,245**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
55	Veis	Riza	Hoxhaj	2436	121/32	5700	Arë	732	335	**245,220**	Levan	Konfirmuar nga ASHK-ja
56	Viktor Liko Gjeçi, Irma Viktor Gjeçi, Edmira Viktor Gjeçi			1941	87/9	8950	Arë	4604	427	**1,965,908**	Havaleas	Konfirmuar nga ASHK-ja
57	Andrea	Liko	Gjeci	1941	87/10	6250	Arë	705	427	**301,035**	Havaleas	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera paraprake										**24,278,233**		

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 76
Datë: 2022/05/20 13:19:26
755da781-6921-4ab3-895f-67d0337fad78

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë